



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
MINISTRI

Bulevardi "Bajram Curri" Tirana, Albania - Tel/Faks. +355 4 362937 - [www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)

Nr. 243 / Prot. 2

Tiranë, më 24.1 2008

URDHËR

Nr. 15 Datë 26.1.2008

P Ë R

**TRAJTIMIN MJEKSOR NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE  
PUBLIKE TË PERSONAVE TË DHUNUAR NË MARRËDHËNIET  
FAMILJARE**

Në mbështetje të nenit 4, të pikës 102 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2.a të Ligjit nr. 9609, datë 18.12.2006, "Për parandalimin e dhunës në familje" **me qëllim**, ofrimin e shërbimit mjekësor dhe psikologjik për personat e dhunuar në familje.

**URDHËROJ:**

1. Çdo person i dhunuar në marrëdhëniet familjare përfiton në çdo kohë ndihmë mjeksore dhe psikologjike nga institucionet shëndetësore publike.
2. Trajtimi i personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare, do të kryhet në:
  - Qendrat Shëndetësore në bashki dhe komuna;
  - Shërbimet e Urgjencës;
  - Spitalet ditore;
  - Spitalet në nivel bashkie;
  - Spitalet nivel qarku;

3. Trajtimi i personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare në institucionet shëndetësore publike të mësipërme, të kryhet falas. Shpenzimet e trajtimit të këtyre personave do të mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
4. Të gjitha rastet e personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare të cilat marrin ndihmë mjeksore në institucionet shëndetësore publike të evidentohen në bazë të Urdhrit të Ministrit nr. 16 datë 23.1 " Për evidentimin e personave të dhunuar në regjistrin dhe kartelën individuale për viktimat e dhunës në familje"
5. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Planifikimit Shëndetësor.
6. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**NARD NDOKA**

